

MË KANË FOLUR MURANAT

ADEM ZAPLLUZHA

**MË KANË FOLUR
MURANAT**

Redaktor:
Mehmet Rrema

Recensent :
Mehmet Rrema

Lektor:
Veli Veliu

Piktura në ballinë :

Besim Lutolli - Beci

MË KANË FOLUR MURANAT

ADEM ZAPLLUZHA

MË KANË FOLUR MURANAT

Shtëpia botuese
TRENDI
Prishtinë 2020

Një vështrim rreth vëllimit poetik “Më kanë folur muranat” të poetit Adem Zaplluzha

Mehmet Rrema

Shpesh herë na ndodh që të presim diçka të na vijë. Presim diçka edhe pse ndoshta nuk dimë se si, ajo që presim do të jetë. Ndoshta presim diçka vetëm duke u bazuar në përvojë apo në një imagjinatë. Gjithnjë gjatë pritjes për t'u njohur me atë që për herë të parë vjen e troket tek ne na pushton një ndjenjë disi e papërcaktuar një si ankth, si pa durueshmëri. Por kur bëhet fjalë për një vepër të poetit Adem Zaplluzha kjo pa durueshmëri bëhet më e theksuar. Bëhet tillë pasi edhe pse e panjohur, duke njohur vetë autorin, imagjinata në mendjen tonë kthehet gati në një realitet.

Poeti Zaplluzha në galaktikën e tij të krijimit, (ku unë tani kam në dorë vëllimin e 191) me pozitë e tij, na fut në një botë të pafundme figurash e ngjyrash, na mbërthen në peizazhet e tij të pafundme saqë vërtetë duket se jemi në një galaktikë të panjohur, por rrugët e sajë, edhe pse janë krejtësisht të ndryshme nga ata që kemi parë në veprat e mëparshme, pasi në çdo vepër ai na sjell

peizazhe të reja. Por prapë Zaplluzha ka të përbashkëtën e tij, identitetin e padiskutueshëm dhe që krijon një lidhje harmonike midis poezive e midis veprave. Në çdo vepër të tij, çdo gjë është e paraqitur me shumë saktësi e qartësi, gjë që prap na bën të mos e humbim për asnjë çast drejtimin.

Poeti Zaplluzha, me vargun e tij të fuqishëm dhe rrezatues, me gjuhën e leksikun shumë pasur dhe të pastër, me një elegancë të pashoqe letrare, me përdorimin e figurave letrare në kohën, formën dhe vendin e duhur, bën që poezitë e tij të ngjajnë me një pikturë magjepsëse, që na mbërthen në çdo detaj të saj. Poezitë e këtij vëllimi, të parë në këndvështrimin e plan vendosjes, të japin përshtypje e një të vetme të ndarë në tre strofa, me lidhje organike, e të, pa ndashme njëra me tjetrën. Ideja që përshkon të gjithë këtë vëllim qëndron dhe mbahet në tre kolona të një trekëndëshi të fuqishëm. Në bashkimin e gjithë shqiptarëve kudo janë pa marrë para sysh hapësirat gjeografike. Sapo një pjesë e këtij atdheu ka nevojë, ky bashkim është i menjëhershëm. Kjo bën që të mos ketë vështirësi e armik, cili do qoftë që na thyen. Kolona tjetër është vigjilenca që duhet

të jetë tek çdo anëtar i kësaj shoqërie. Kemi qenë dhe jemi në synimin e korbave të zi me shajkaqën e zezë në kokë, të cilët herë duke përdorur forcën e më shumë djallëzinë duan të na përçajjnë e copëtojnë, për të na zhdukur. Dhe kolona e thërret me një thirrje të fuqishme, prej atdhetari të vërtetë, prej një burrë odash e kuvendesh, në që poeti lëshon për të mos u largua nga atdheu. Po u larguam, do të na përfshij harrimi, dhe vendi do të mbetet në dorë të kukuvajkave..... Në këtë vëllim, pak më ndryshe nga vëllimet tjera, ku poeti përfshin gjithë hapësirën kombëtare, poeti është ndalur në një cep të atdheut, në atë cep kur në një kohë të shkurtër, vetëm tridhjetë sekonda, i gjithë atdheu nga lindja në perëndim e nga jugu në veri, u trondit aq thellë sa kurrë ndonjë herë më parë. U trondit, por asnjë herë më parë nuk i pati radhët kaq të shtrënguara.

Nën muranat e shembura
Si nga lashtësia e dheut
Dëgjohen vigmat
I tërë kombi në këmbë
Hapen dyert e shpresës
Hapen zemrat e mbyllura gurë
Në këto tridhjetë sekonda, ka ndodhur vetë

kataklizma. Poeti këtu na përshkruan, sikur vetë të kishte qenë aty në atë çast, të shikonte, dëgjonte, fotografonte e të na rrëfente në imtësi, atë tragjedi, atë tmerr që ndodhi. Në ato tridhjetë sekonda mbi këtë copë atdhe rrënimi që kaq i madh sa edhe në mijë vjeçar s'pat ndodhur. Aty thirrjet dukej se vinin nga mijë vjetarët , por edhe përgjegja që me shpejtësi vetëtime

Qanë nusja me ngashërim

Diku dënes një nënë

Qan një nuse...dënes një nënë... Ja me çfarë madhështie na e jep poeti nënën shqiptare. Në këto çaste të rënda tragjedi, kur edhe shkëmbinjtë e malit apo vetë uji i detit, bashkë me nuset tona të mira, nuk mund ta mbajnë vajin, nënat tona janë shkëmb mbi shkëmb. Ata ligështohen, por nuk dorëzohen, nuk bien në gjunjë, e për këtë janë sprovuar në shekuj. Në vargjet e poezive të Adem Zaplluzhës, ka thellësi dhe gjerësi mendimi.

Brigjet e brengosur

Përcillnin pulëbardhat

Mendimet dhe shprehjet e tij kanë ngarkesë të fuqishme filozofike, të cilat shprehen bukur nëpërmes figurave letrare si në këtë rast kur brigjet tona i ka mbërthyer një brengë, të cilën gojë më gojë e vesh më vesh

përhapin lajmin anë e mbanë atdheut.
Nga një dridhje e egër

U gjunjëzuan pemët

Përfundimisht u gjunjëzua plepi i egër
Pra qe një gjëmë e madhe që bëri të
gjunjëzohet, plepi i egër, ai plep i cili nuk e
ka ulur kokën asnjë herë, i ka pritur furtunat
me gjoks dhe i ka thyer. Por kurrë nuk është
dorëzuar. Dhe ja poeti me forcën e fjalës së
tij në një tjetër poezi i bën të ditur çdo
furtune, ngado që të vijë, e prej kujtdo që të
vijë,

Se kjo tokë Asnjëherë nuk iu është dorëzuar
askujt

Se kur është puna çohen në këmbë edhe
gurët ndër varre, dhe nuk ka tërmet që i
mund shqiptarët e bashkuar. Zapluzha, me
krenarinë e një atdhedashësi që e
karakterizon, me krenarinë e një poeti që i
përket denjësisht gjithë kombit, thotë plot
krenari se Lëvizën gurtë e murrme të
atdheut

Lëvizi ndërgjegje e fjetur

Pra poeti ven re se në këto raste, ndërgjegjja
e fjetur, ndasitë që vihen re ditëve të
zakonshme, lëvizin, bashkohen dhe si një i
vetëm i fuqishëm përballojnë çdo vështirësi.
Kështu ai ven re se

Këto plagë e ky dimër
Pothuajse ishin dikur këtu
U printe bajraqeve
U prinë bajraqeve se ata, djemtë e Kosovës
qenë të parët sapo morën vesh si vetë një tufë
shqipesh sa hap e mbyll sytë, u gjendën aty
ku dhembja qe më e madhe. Ky veprim, kjo
gatishmëri e një, populli të bashkuar, e bën
poetin tonë të jetë krenar
Kur bien zjarret e mëdha
E ka tërmet
Unë gjithmonë
Dhe kurdoherë krenar
Në atdheun tim
Do ndjem si mbret Dhe ky bashkim i
forcave i kujton poetit kohën e madhe, atë
kur populli ynë ishte në kohën e Gjergj beut,
të bashkuar dhe të pathyeshëm
Ne sërish
E sërish si gjithmonë
Do jemi bedena
Ashtu siç ishim
Në kohën e Gjergj beut Poeti Zaplluzha si
një njohës i përsosur i psikologjisë dhe
filozofisë se popullit tonë, si një këshillues i
zoti dhe i drejtë, nëpërmes metaforave të tij,
si dikur burrat motit, në odat e kuvendit, na
tregon se ku dhe si mund ta gjejmë ne si

komb, forcën për të ecur drejtë zhvillimit
Forcën tënde të brendshme
Mos e kërko askund
Përpos në brendinë e pasqyrës
Nga e cila të ndjek kudo
Hija e jote e tejdukshme ,
ku duhet të mbështetemi për të përballuar
sulmet e papritura që mund të na vijnë nga të
katër anët. Autori si gjithmonë është i
kujdesshëm dhe vigjilent. Mbështetur në
historinë e kombit tonë, synuar, të kërcënuar,
të luftuar,të synuar për ta asgjësuar, ai na
porosit të jemi kurdoherë, e sidomos në çaste
të vështira, të bashkuar e vigjilent, sepse
pikërisht atë herë, bisha e tërbuar, herë me
mënyra të hapura e herë të kamufluara, duke
mësy të futi mes nesh tradhtinë, ashtu si kali
i drunjte ,që të na zërë në përgjumje
Mej moj bishë e tërbuar mej
Në daç hap plagë të reja në këtë gjoks
Por mos prek në këtë mënyrë kaq tinëzare
Lashtësinë shekujve Më kanë folur
muranat,thotë poeti, pra këtë deduksion ai e
ka nxjerrë nga eksperiencia, nga historia jonë
e pasur me raste pabesisht e tradhtisht, e
pasur me qëndresë e me fitore
Një tjetër brengë e poetit,e cila e shqetëson
çdo ditë e më shumë, është një plagë që sa

vjen e zmadhohet në trupin e bukur të atdheut. Është plaga e braktisjes së atdheut nga bijtë e tij. Kjo është edhe ajo që duan dhe punojnë, pa ndërprerë me të gjitha mënyrat, armiqtë tonë. Është rinia që është edhe pjesa më vitale, më e gjallë e më e fortë, ajo që ka marrë rrugën e panjohur e nget me nxitim drejtë greminës apo qejfeve Në ciklin e tretë të këtij vëllimi poetik, poeti Zaplluzha, si në shumë vepra të tij, ku kjo temë zë një vend të rëndësishëm u bën thirrje të rinjve të mos largohen .

Sonte kam një festë të madhe

Vendosa të ngrehi dolli

Me guralecët

E të gjitha ngjyrave

Nëse duhet do e ftojmë edhe kalanë
 Të pimë e të dehemi me dashurinë e saj
 Po pra, poeti sa herë që kthehen djemtë nga kurbeti, sa herë rrugët e lagjeve e qyteteve tona gumëzhijnë nga të kthyerit, të cilët i japin gjallëri vendit e kjo gjallëri shikohet qartë e hapur në sytë dhe shpirtin e poetit i cili del t'i presë me zambakë, të rritur në tokën e pëlleshme të vendlindjes e vaditur me ujin e pastër të Lumëbardhit, uji që arrin deri në detin jon, duke çuar atje "guralecët e të gjithë ngjyrave". Me këto "guralecë" poeti

ynë është i gatshëm të marrë e të mbrojë çdo kala, por pa këto....Eee, është e vështirë të ruhet kalaja jonë e madhe,se vetëm me djemurinë mund të arrij ky vend aty ku përmendoret...

Të mbërri tok me djemurinë

Deri këtu ku përmendoret

I bëjnë roje nderi atdheut Por ky gëzim i poetit, shpejt ia len vendin një dëshpërimi për të cili ai gati në përgjërime u lutet bashkëqytetarëve, u lutet të rinjve të mos largohen sepse qytetet dhe fshatrat tona do të mbeten amanet kukuvajkave. Do të gëzohen zogjtë ndjellë keq,do të gëzohen korbata e zi, me shajkaqën e zezë mbi kokë të gatshëm që të rikthehen në vendin e krimit.

Askund nuk shoh njeri

Qyteti paska mbetur amanet kukuvajkave Dhe po mbeti vendi në dorë të korbave, do të na duhet të na duhet t'u kthehemi kujtimeve, të cilët siç thotë poeti nuk dinë të plaken. Malli zë mallin në rrugë e rruga kthehet në mall, kthehet në kujtime aq sa, si thotë poeti Zaplluzha, kujtimet nuk dinë të plaken Por për çudi

Kujtimet nuk dinë të plaken ,

nuk plaken, sidomos kur njerëzit bëhen të huaj për njëri tjetrin dhe këtë harresë askush

më shumë se ikja, emigrimi nuk mund të na e shkaktoi, e askush më shumë se korbat me shajkaqë në kokë, nuk e dëshiro, e për këtë, mjeshtri i vargut, mjeshtri i figurave letrare, mjeshtri i poezisë vjen në këtë vëllim edhe një herë me thirrjen për të mos e braktisur për asnjë arsye vendin, se kudo që të shkojnë, nuk do të ndjehen si në vendin e tyre, se kudo që të shkojnë, një gur i shkullur do të jenë, e me gurë të tillë nuk ndërtohet e mbrohet kalaja...

Për çudi këtu njerëzit

Sa janë të huaj për njëri-tjetrin

Adem Zaplluzha është një poet që nuk di të dorëzohet, që nuk s'di të përkulet nga furtunat. Ai edhe pse përshkruan me vërtetësi brengat e popullit tonë, prapë aty për aty gjen forcën, sigurinë, rrugën dhe optimizmin për të kaluar e përballuar çdo furtunë. Dhe këto ai i gjen pikërisht aty, në popullin tonë vital. Dhe ja me çfarë force e krenarie vjen tek strofa e fundit e këtij vëllimi

Nga zjarri u linda

Dhe sërish jam zjarr

Kurrë s'i shëmbëlleva hirit

Feniksin e pata vëlla prej gjaku.

Dhe unë, duke lexuar këtë vëllim, si shumë të tjerë të opusit të tij, ndjehem krenar që

letërsia jonë shqipe ka një,poet mendje ndritur, siç është Adem Zappuzha,që poezia jonë ka në fondin e saj të artë vepra të tilla me vlera kombëtare e të dëshiruara edhe ndërkombëtarisht të këtij poeti.

Urime e suksese pa fund poet mendje ndrituri ynë .

Cikli i parë
Mos u dorëzo nga ky tërmet

LATON ÇDO ASHKËL DËRRASE

Kur të kthehem
Asgjë s'do të jetë më si dikur
Nëpër xhepat e skamjes
Asnjë qindarkë s'do të ketë
Për funeralin tim

Mos më pyetni se ku isha
Çfarë bëra
Në udhëtimet e mia të gjata
Kudo që shkela
Më duket se dëneste nata

Ishte një udhë e gjatë
Nëpër të cilën kaluan vërdallë
Shumë njerëz para meje
Shkelën dhe u kthyen
Me xhepa të zbrazëta deri te një funeral

Një arkivol te dunat e kujtesës
Nga druri i atdheut
Gdhend të kaluarën e hidhur
Laton çdo ashkël dërrase
Me lotin e ngrohtë të tokës mëmë

NGA DHEMBJA PO SHKULEN ÇATITË

Nuk mbaj mend se ku isha
Dheu i huaj
Mi gërryente mushkëritë
Te ullinjtë e atdheut
Gjëmonin ethet e tërmeteve

Gjethet e fishkura dënesnin
Si kurrë më parë
Nga rrënjët e shkultura
Shtrydhnim atë pak lot
Që kishte mbetur si amanet i tokës

Ne kishim uri
Para se të lindnin
Këtu vdisnin mëngjeset
Nëpër rropullitë e zbrazëta
Frynte një stuhi stërkalash

Në atdheun tim
Nuk paskan të ndalur
Këto dridhje të çmendura
Po dridhen pemët deri në rrënjë
Nga dhembja po shkulen çatitë

HAPEN ZEMRAT E MBYLLURA ME GURË

Gurtë që lëvizin si fjalët
Pemët kokëposhtë
Nga rrënjët e mykura
Shtrydhin oksigjenin e fundit
S'mund të marr frymë
Me këta mushkëri të grisur

Një tjetër dridhje mjegullash
Nga parzma e qiellit
Çurgon si qumështi i nënës
Kjo lloj vdekjeje
E cila kurrë s'pati të ndalur
Në fjalët dhe trojet tona

Nën muranat e shembura
Si nga lashtësia e dheut
Dëgjohen vigmat
I tërë kombi në këmbë
Hapen dyert e shpresës
Hapen zemrat e mbyllura gurë

DIKU DËNES EDHE NJË NËNË

Këtu një britmë
Atje poshtë një piskamë
Ca vigma të trishtuara
Dëgjohen në çdo anë

Çfarë grithje fytyrash
Te portat e thyera
Vajttime ullinjsh
Mes rrënjëve të shkulura

Ç'po ndodh kështu në këto boka
Me këto gjëma
Është çmendur toka
Dëgjohet larg vaji e vikama

Si përrallat e lashta
Duken këto trishtime
Kudo gërmadha
Mbi plagët e tokës sime

Diku një vajë e trishtim
E diku tjetër një piskamë
Qanë nusja me ngashërim
Diku dënes një nënë

ERRËSIRA E VERBTË TËRË HABI

Shikoj përtej dritareve të erës
Ti vrapon
Nëpër vrimën e gjilpërës
Më vonë trishtimi pushon
Te xhepat e grisura të pantallonave

Një tjetër diell galopon
Hapësirave të murrme
Shiu i egër nuk men
Nëpër kopshtet e djegur
Si sy macesh dallohen gacat e zeza

Këto copëza thëngjilli
Pa asnjë shenjë jete
Ngacmojnë errësirën
Ky diell i vobektë
Sivjet s'hyri nëpër shtëpitë tona

Nga dritaret e mbyllura
Dalin në shesh xixëllonjat
Errësira e verbët tërë habi
Nga xhepat e natës
Nxjerr qymyr gjysmë të djegur

STËRKALAT E MËNGJESIT VDESIN NGA URIA

Lajmet kanë zënë e po vjetrohen
Si buka bajate
Askush më nuk i përtyp
Këtu u shemb një përrallë
Atje u rindërtua një trillim

Nëpër lagjet dhe muranat e kripura
Ndjej djersitjen e pemëve
Avulli i dendur i mëngjesit
Rëndohet si plumbi
Mbi qerpikët e brymtë të ditës

Thonë se një varkë e fundosur
Si kuajt e detit
Vrapon nëpër plagët e dallgëve
Dielli në këtë qytet
Përkundet si një anije e braktisur

Dikur vonë tepër vonë
Filluan të zgjohen nga tasat e konservave
Peshqit e ngordhur
Por askush nuk e ha këtë gjellë
Stërkalat e mëngjesit vdesin nga uria

KJO STINË E VDEKJEVE

Njerëzit me këmbëngulje pohuan
Se është koha e zanoreve
Pemët heshtën
Vetëm gurtë e lagjes
Iu bashkuan bashkëtingëlloreve

Te moli i kujtimeve qante taverna
Qanin edhe gratë
Shamitë e bardha në kokat e plakave
Si shtërgjet e atdheut
Valëviteshin mbi dallgët e thyera

Brigjet e brengosur
Përcillnin pulëbardhat
Përcillnin deri te majat e reve
Kjo stinë e vdekjeve
I mbushi varret me plagë motesh

U GJUNJËZUAN PEMËT

Në këtë hapësirë
Përpos heshtjes vetëm zëzëllimat
Dhe mjaullimat e maceve
Dëgjohen netëve të vona
Nga sytë e lakuriqëve të natës
Derdhen lumenjtë e kristaltë

Ky shi i vonuar erdhi befasisht
Trokëlliu nëpër portat e mbyllura
Asnjë dru nuk i hapi dritaret
Vetëm sterrës së tunxhtë
Nën thundrat e topitura të ditës
I dëgjohej gjëma e dhembjes

Nuk patëm shumë kohë
Me rrëmbim ia mësynë
Milingonat e verdha
Nga një dridhje e egër
U gjunjëzuan pemët
Përfundimisht u gjunjëzua plepi i egër

DËNES SI NJË KËRTHI I BRAKTISUR

Gjatë dridhjeve të vogla
Gjërat humbin kuptimin
Dhe formën
Një lëvizje e pakontrolluar
Shkulë rrënjët e manaferrave
Kërmijtë ngjiten mureve
Egërsisht ngjiten deri të mjegullat

S'dëgjohet asnjë zë njeriu
Heshtin pemët
Kopshti i stepur nga frika
Si një kalë prej druri
Në shuplakat e pemëve
Të shkulura
Përcjellë rritjen e barit

Dikur vonë kur men frika
Secili njeri
Në brendinë e vet të gurtë
Dëgjon lehjet e pandërprera
Të të gjitha llojeve
Dëgjon vetveten se si qanë
Dënes si një kërthi i braktisur

ASKUSH NUK BËZAN

Nëpër këto shtëpi të zbrazëta
Vetëm frika banon
Përpos dridhjes së çatisë
Askush nuk trokiti mbrëmë
Erdhën dhe befasisht
U larguan hijet e murrme

Në mes të kopshtit
Dëgjuam zërin e erës
Një nënë
Thërriste si të ishte në jermi
Askush nuk bëzan
Në heshtjen e varrit lebetiten pemët

KJO NATË E GJATË E TMERRIT

Mes gishtave hapen varret
Një kuçedër
S'ka gjasa të mej
Përpinë edhe drurin e fundit
Në kopshtin e Edenit

Kjo duhmë e vdekjeve
Po i përmyt varkat e fundosura
Një gjeldeti
Se zog mali fluturoi
Nëpër gjeografinë e dhembjes

Ra një heshtje e tunxhtë
Pranë vareve të huaja
E gjeta arkivolin tim
Kjo natë e gjatë e tmerrit
Më duket se posa ka filluar

I NUMËRON EDHE ATA

Në zemërimin e valëve
Mbyten trëndafilat prej uji
Nga shpirti i tokës
Burojnë shirat e tërë dynjasë
Çfarë të bëj me ty
Kur më mungon frymëmarrja

I kërkoj kudo në botë
I kërkoj sqepat e lejlekëve
Asnjë vezë e kuqe
Nuk gjendet në strofujt e pikëllimit
Ky det e kjo tokë
Sa herë gjëmuan përpinë nga një pëllumb

Sërish mbeta i vetëm
Kjo shtrojerë prej dërrasave
I numëron kalimtarët e rastit
I numëron edhe ata
Që bartin qivurin e një kohe
Të cilin e presim te portat e varreve

MBI VARKAT E FUNDOSURA

Gota e thyer dhe një lule
Pranë tavolinës
Një aromë dehëse
Mes dallgëve të kujtesës
Noton nëpër brishtësinë e damarëve

Sa pak gjak paska mbetur
Në rrënjët e ullirit të djegur
Kjo tokë e cila
Për çdo ditë dhe në çdo kohë
Po i shkund shpatullat e dërmuara

Tavolina e vetmuar
Dhe gota e dehur
Një duet i përkryer për korin
E bretkosave
Kur në kopsht heshtin mimozat

Çfarë nuk përjetuam deri më sot
Fishkjet e luleve
Dhe derdhjet e gjetheve
Mbi varkat e fundosura
Për herë të parë çelin luleshpatat
Prishtinë, 1 dhjetor 2019

MOS U DORËZO NGA KY TËRMET

Sot përjetuam vdekjen e fluturave
Një krah i thyer
Kurrë më s'mund të fluturoj
Nëpër qiellin e mbetur peng
Dhembjeve dhe plagëve pa gojë

Ky tërmet i çmendur
Për së mbrapshti ia ka mësy atdheut
Por mbase ka harruar
Se kjo tokë
Asnjëherë nuk iu është dorëzuar askujt

Ishte nata ku nën rrënojat
E qytetit të pavdekshëm
U dëgjuan gjëmat
Deri në Fushën e Mëllenjave

Ku shtatë ditë e shtatë net
S'do pushojnë vigmat
Nënë moj mbaje ison e durimit
Mos u dorëzo nga ky tërmet

Ani që u lindëm
Nga shpirti i mjerimit
Ne gjithmonë ishim
Dhe jemi krenarë si mbretër

LËVIZËN GURTË E MURRMË TË ATDHEUT

Ende pa zbardhur agullima
Në ethe dridhej muzgu
Një hata si lugat
I shtrin duart e mermerta
Shtrinë ta përqafoj vdekjen

Nga sytë e gjakosura të dallgëve
Fluturuan zogjtë e shpresës
Një dridhje zemre
Tundi deri në alivanosje
Tundi lotin e sapo dalë nga sytë e mëngjesit

Më pastaj pllakosi heshtja
Heshtën lëvizjet e pakontrolluara
Të gurëve të latuar
Çatitë dhe tjegullat përqafulan
Pluhurin dhe vdekjen e një vdekjeje

Një copë e kuqe prej mermeri
Mbase ishte lënduar tej mase
Filloi të dënesi
Lëvizën gurtë e murrme të atdheut
Lëvizi ndërgjegje e fjetur

ËSHTË DRIDHJA E SHPIRTIT TË ATDHEUT

Sërish parandiej lëvizjet
E lugetërve të nëndheshme
Një duhmë e rëndë dheu
Ma zë frymën
Ligështohen rrënjët e ullinjve

Ah ullinjtë e shkukur
Të atdheut tim
Kam besuar dhe gjithmonë besoj
Se do jetoni
Më shumë se njëmijë vjet

Nuk është kjo dridhje
Ajo valle madhështore e Osman Takës
As tingujt melankolikë të zurnasë
Por tundja e shpirtit të atdheut
Nga thonjtë e gjakosur të tokës

KJO GJËMË MBI GJËMËN E TOKËS

Çfarë duel deshësh
Po ndodh në tokën e Arbrit
Brirë të thyer kaprojsh
Dhe lëkura të dhirtë ujqërish
Dolën nga rropullitë e Adriatikut

Nëpër mëhalla dhembjesh
Nuk mejnë të lehurat
Dëgjohen edhe mjaullimat
E trishtuara të një mëngjesi
Këtu vdekja vulosi gurtë e varreve

Një lot përtej lotit
I fshinë nga sytë e dhembjes
Të zgërlaqurat e trishtuara
Ishte një mallkim i lashtë
Ose ne i primë mallkimit të sotëm

Por gjithsesi u zgjuan
Lugetërit e nëntokës
Kjo gjëmë mbi gjëmën e atdheut
Shkulë nga gjoksi i plagosur
Zemrat tërë avull të njomëzakëve

MUSTAQE PRERË NJË PLAK

Këto zhurma të nëndheshme
Zërat që vijnë
Nga lashtësia mos janë vallë
Mallkimet e etërve

E kjo dridhje flokësh
Që po na i lëndon të gjitha ëndrrat
Thëllime shpirtrash të gjallë
Mbi thinjat e një plage që s'ka shërim

Çfarë s'përjetuan sot sytë
Panë një nënë me flokë të shkulura
Mustaqe prerë një plak
Dhe një nuse pa duvak

NE DO JEMI GJITHMONË KËTU

Mbi qiellin e vrarë shtatë herë
Mbrëmë u shua dielli
Një hije e rëndë prej tunxhi
Zbriti mbi kokat tona

Kjo peshë e rëndë
S'durohet më
Ky diell i verbët pa mëshirë mbuloi
Gjeografinë e atdheut

Një kohë të gjatë
Do presim gjumin e ikur
Ah këto pampersa fëmijësh
Po qullen si ëndrrat e mia

Disa kavak të lartë
Me krenari shikojnë gërmadhat
Ne do jemi gjithmonë këtu
Edhe pas vdekjes së gurëve

SA I TRISHTUAR DO JETË DIMRI SIVJET

Sërish dhe sërish nuk ndalen
Së dridhuri
Këto pemë të njoma
Nga loti i hidhur i atdheut
Çurgon një tjetër lot
Më i hidhur se kurrë më parë

Mbrëmë te plepat
I dëgjuam vigmat e gurëve
Me ngashërim të padëgjuar
Dënesnin edhe guaskat
Në një tas të vjetër konserve
S'mejnë as britmat e shkumës

Ky diell i ngratë
Qëmenatë mbeti pa rreze
Një shpatë prej rrufeje
Ua preu udhën rrezeve të ngrohta
Sa i trishtuar do të jetë
Ky dimër i ashpër sivjet

PO KTHEHEN

Këto plagë e ky dimër
Pothuajse ishin dikur këtu
Janë ulur këmbëkryq
Dhe qëndrojnë stoikisht
Mbi plagët tona të pashëruara

Më janë shterur lotët
Nga bebëzat e ballit
Të plagosur e të vrarë
Pikon rëra e vaktë
Përzier me lotët e pulëbardhave

Nëpër metaforat e dhembjes
Po kthehen shtërgjet
Tok me dallëndyshet e plagosura
Po kthehen
T'i shërojnë lotët e atdheut

DHE U PLANDO

Nëpër rrugë gota të thyera
Si gjysmëhëna
Duken tenxheret prej bakri
Një dhjetëshe lugësh
Dhe fshesa mbi një tavolinë
Luajnë tangon e tmerrit

Njeriu me lopatë në dorë
Gërmon
Thellë gërmon themelin
E një binaje
Si i çmendur gërmon
Nëpër rrënjët e shkulura të tokës

Nga diku larg kishte mbërri Deniku
Përvajshëm frynte mbi
Flokët e thinjura të një murane
Të cilën sapo e lëshuan këmbët
Dhe u plandos
Mbi një grumbull gurësh

MBI FLOKËT E THINJURA TË VJESHTËS

Përballë tjegullave të thyera
Apartamenti i përgjumur
Sapo i fshiu sytë
Një tjetër e tjetër dridhje
Kafshoi ashtin e dritareve

Këlthitën xhamat e thyera
Nën avullin e ngrohtë
Të vrushkujve të gjakut
Si lugat u ngrit në këmbë
Bisha e pashpirt

Shtatë britma të theksuara
Jehuan nëpër palcën
E dhomës së përgjumur
Shtatë here dëgjuam vajin e kambanës
Herën e tetë heshtën lulet

Përsëri kjo vdekje
Si egërsira i vërsulet jetës
Vërsulet egërsisht
Mbi flokët e thinjura të vjeshtës
Dimri sivjet vdiq para kohe

NJË PULËBARDHË POSA E ARDHUR

Një i ligështuar nga tërmetet
Shikon zbrazëtin e dhomës
Era e shembur
Fshihet pas shpatullave të pasqyrës
E cila lëvaret si një kufomë
Mbi tjegullat e rrënuara

Disa stërkala lotësh
Kush e di se nga na erdhën
Nën suvatimet e këputura
I qullin ëndrrat
E një qifti posa të martuar
Qullin një fillim të mbetur peng

Vrushkuj avujsh të nxehtë
Burojnë nga oxhaqet
Që nuk pësuan shembje
Ka ky tërmet i çmendur
Një pulëbardhë posa e ardhur
Shikon me dhembje dallgët e këputura

DO T'UA ZGJATË DORËN E SHPËTIMIT

Në këtë qerthull dhembjeje
Prej pluhuri
Betoni kryeneç pështynë suvanë
Në të katër anët e dhembjes
Hapen plagë
Nga ato më të trishta

Çatitë kokëposhtë dhe të shembur
U shëmbëllejné
Shelgjeve të pikëlluara
Qajnë si zogjtë e lënë pas dore
Ky dimër i acartë
Më dhëmb hekuri kafshon gurin

Të pashpresët të lënë diku askund
Si trumcakët bredhin udhëve
Të shpresës së humbur
Mos vallë dikush i huaji
Do t'ua zgjatë dorën e shpëtimit
Do t'ua zgjatë jetën në këtë dimër
Prishtinë 2 dhjetor 2019

KËTO PEMË PASKAN MBETUR PA LOT

Mjegullat e bardha prej pluhuri
Kërcitje trarësh
Dhe një heshtje mortore
Mbi një arkivol
Noton qyteti i vdekur

Erdhën nga të katër anët e atdheut
Sharri idhnak
U printe bajraqeve
Por nuk e mundën dot dhembjen
Fluturat e bardha të Kosovës

Nën gërmadha gurësh
S'pushojnë gjëmat e ullinjve
Një degë e thyer në shtatë pjesë
Shtrihet brigjeve të lënduar
Qenkan shterë lotët e Adriatikut

Një nënë Çame dënes
Ka kohë kur u shterën lotët e saja
S'vajton dot
Ah çfarë dhembje
Këtu pemët paskan mbetur pa lot

Cikli i dytë
Më kanë folur muranat

KURSE ZJARRET DOGJËN DHE I POQËN

Kësaj pikturë anonime
Po i mungon vetvetja
Asnjë ngjyrë
Nuk e paska shijen
Dhe formën e saj elipsoide

Përtej thellësisë së këtij imazhi
Paraqiten disa pamje
Abstrakte
Me forma të ngjashme
Dhe shije të lulediellit në perëndim

Të korrurat sivjet përfunduan
Më herët
Seç planifikoi natyra nënë
Një zjarr i pakontrolluar
Vrapoi me Kalorësit e Apokalipsit

E tërë toka filloi me shtërzimet
E saja të lindjeve
Gjelbërimi abortoi para kohe
Kurse zjarret dogjën dhe i poqën
Foletë e lashta të xixëllonjave

NGA NJË FALTORE E HUAJ

Ne s'kishim kohë për ju
Ishim të zënë me vetveten
Dhe fluturat e bardha
Sa herë që i ndezëm qirinjtë
Nga qielli sterrë
Shkundeshin yjet klandestinë

Thonë se ishim të huaj
Në vatrat tona
Dyert na i mbyllte i huaji
Sa herë që trokitëm në ndërgjegje
Edhe më egërsisht
Mbylleshin portat e hekurta

Më kujtohen dimrat e egër
Bora e zezë
Ua zinte frymëmarrjen lisave
Nga një faltore e huaj
Në çdo kohë e stinë
I kontrollonin të rrahurat e zemrës

MEGJITHATË MË KANË THËNË

Më pat thënë një mik
Se psalmet janë si lulet e Edenit
Kur piqen mollët
Era lozonjare
Luan vallen e saj të fundit

Edhe pemët e tjera piqen
Degët çelin gonxhe të bardha
Edhe me disa ngjyra
Të tjera
Mund të krenohet ky kopsht

Megjithatë më kanë thënë
Se nuk mund të krenohet
Me mbamendje
Gjithmonë harron dhe ka harruar
Se lulet e bardha s'çelin në pranverë

UNË SËRISH

Kur bien zjarret e mëdha
E ka tërmet
Unë gjithmonë
Dhe kurdoherë krenar
Në atdheun tim
Do ndjehem si mbret

Nëse shkunden
Dhe dridhen e përdridhen
Malet
E gjethet bien në det
Unë prapë
Dhe prapë në atdheun tim krenar
Do të ndjehem si mbret

ISHIM FËMIJËT E YJEVE

Nëse çohen peshë
Zotat e Olimp
Çohen
Për t'i shkullur
Rrënjët e pa shkullura të atdheut

Ne sërish
E sërish si gjithmonë
Do jemi bedena
Ashtu siç ishim
Në kohën e Gjergj beut

Mbase jemi një popull
Që nga palca e gurëve
Shtrydhëm dashurinë
Ishim fëmijët e yjeve
Të tjerëve ua mbollëm ardhmërinë

THËLLIMI NË KOPSHT

Kohë e ngrirë
Dy duar prej mermeri
Si përmendore të lashta
Qëndrojnë në xhepat e statujave

Era mospërfillëse
Rrëmbyeshëm frynë nëpër zgavrat
E një rrashte të thyer
Një thëllim frynë një tjetër erë

Shikoj përreth pemëve
Gjelbërimi nuk e ka ndryshuar ngjyrën
Ftohti i përballueshëm
I ka mbështjellë ollukët e ndryshkur

Sot asnjëri s' e ka mbështjellë kokën
Ky dimër posa ka filluar
Thëllimi në kopsht
Ulur këmbëkryq shikon përtej maleve

NËN DEGËT E NJË GËSHTENJE

Asgjë nuk merr frymë
Ulur në trotuarin e këputur
Në bel
Një nënë mënd foshnjën
E posa të lindur

Në këtë vdekje të madhe
Një jetë gojëhapur
Shikon horizontin
Përtej gjoksit të venitur
Të muranës

Sërish një lëvizje toke
Dridhen pemët
Dridhet edhe foshnja në bark
Nën degët e një gështenje
Abortoi dita e përgjakur

I NUMËRON DITËT E FUNDIT

Dera e korridorit
I mbyllë të gjitha orenditë
Jashtë thëllimi
Me nxitim vrapon diku askund
Bora e parë
Bie ngadalë me flokë të shprishura

Çatia gjysmë e rrënuar
Shikon perëndimin në horizont
Ollukët pikojnë dhembje
Kjo stinë e dasmave
Sivjet i ka mbyllur dritaret
Për herë të fundit nga oxhaku i vdekur
Fluturoi një shtërg i moshuar

Sërish dëgjohen ca rrapëllima dyersh
Korridori i kotur
Rri ulur në stolin e kopshtit
Thua se është në azilin e pleqve
Dhe i numëron ditë e fundit
Të vjeshtës në ikje e sipër

KUSH I HAPI KËTO VARRE

Dora e padukshme
I kyçi të gjitha portat e rënda
Një zog prej druri i gdhendur
Ose prej letre
Ka kohë që rri në brendinë e dyerve

Më duket se të gjitha portat e fshatit
Janë të mbyllura
Qëndrojnë në heshtje
Mu ashtu siç qëndrojnë
Statujat antike të Apollonisë

Si kuajt e egër era kohë pas kohe
Galopon nëpër rrashtën time
Kush i hapi këto varre
Nuk paska mbjellë asnjë pemë
As kryq s'ka ngulur te koka ime

Ky thëllim shpirti
S'paska të ndalur në këto fusha
Mëllenjat e ngrira kurrë më
S'mund të fluturojnë
Në atdheun e etërve të tyre

NË BRENDINË E PASQYRAVE

Përpos gëlqertës së bluar
Asgjë s'ka mbetur nga gërmadhat
Një zog vajtues
Mbi një grumbull gurësh
Me një shami të zezë i fshinë lotët

Zëri bariton si nga honi i largët
Dëgjohet në rërën e përmbytur
Dallgët e kripura
Përzihen me neutronet
E këputura përgjysmë të çatave

Një varkë e thyer nga valët
Përkundet në ëndrrën e saj
Peshqit e uritur
Nëpër tasat e konservave
Protestojnë mbi zhurin e dhembjes

Kalimtarët e vonuar kalojnë
Si hijet morbide
Në brendinë e pasqyrës konvekse
Me ngashërim dënesin brigjet
Te moli i rrënuar vallëzojnë arkivolet

PRITNIM ARDHJEN E PRANVERËS

Me një flutur që mezi
I dallohej ngjyra
Ishte e kaltër ose e bardhë
Por gjithsesi ishte flutur
E cila i kyçte
Dhe i shkyçte deri në mëngjes yjet

Ishte koha kur i ndiznim qirinjtë
Nëpër shandanë bronzi
Dimri ishte i gjatë
Dhe i acartë
Në mungesë të lëndëve djegëse
Ne ngrohnim me qiri frymëmarrjen

Nëpër xhepat e grisur të acarit
I fshehëm të gjitha dhembjet
Dhe me padurim
Pritnim ardhjen e pranverës
Që t'i ndezim sërish
Dritat e kyçura të skamjes

ME KRAHËT E SAJA TË KËPUTURA

Në çastin kur i ulëm flamujt
Filloi një tjetër betejë
Shumë më e vështirë
Se ato që kaluan
Nëpër pantallonat e grisura
Si kali i paçjerrë
Galoponte era e çmendur

Na mungonin dritat
Llambat e ndezura
Me vajguri përzier me vaj ulliri
Kohë pas kohe
I shkyçnim
Frikoheshim si fëmijët
Nga errësira e plumbtë

Për çdo ditë të lume
Dhe në çdo kohë
Një flutur e kaltër
Me krahët e saja
Përgjysmë të këputura
Trokite në dritaren tonë
Trokite duke na zgjuar nga letargjia

S'MEN NË ASNJË KOHË

Në mëngjes zgjohet i përgjumur
Nëpër rrugët e përdala të qytetit
I mbledh dromcat e fjalëve
Të natës së kaluar
Më pastaj
Mbështetet në hijen e saj të mykur

Kur dielli ikën në zenit
Ekuinoksi s' duket askund
Në drejtim të yjeve klandestin
Një hije e verdhë
I zgjatë duart e saja të gjata
I shtrinë edhe vigmat drejtë galaktikave

Ishte koha kur zgjoheshin
Ose flinin njerëzit
Por hija e brymtë e shirave
S'men në asnjë kohë
Duke i shtrirë duart
Për t'i zënë fluturat e verdha

KU BANONTE DIKUR POETI

Mbi këtë tryezë metaforike
Sonte asgjë nuk na mungon
I ke sjellë në këtë tavolinë
Të gjitha ato të ziera
Që më së shumti më pëlqejnë mua

S' paske harruar
Të ma sjellësh librin e poezive
Të Lasgushit
Një shtërg i larmë qenka ulur
Në anën e djathtë të dritares

Shiko sa bukur në këtë gotë
E paske vendosur ëndrrën
E liqenit të përgjumur
Kush e di se sa cicërima fshihen
Në faqet e pluhurosura të fletores

Më kujtohet shtërgu
I vitit të kaluar kur u ndal
Mbi çatinë e asaj shtëpie
Ku banonte dikur poeti
U ndalë dhe dëneste si kërthi

Prishtinë, 3 dhjetor 2019

KRIJOJNË SAGËN

E di që kali i madh
Ai i drunjte
As që ka ekzistua ndonjëherë
Mbase ka qenë një kalë
Supremen
I zbritur nga një tjetër planet

Ka ardhur dhe mes mureve
Të larta
Prej tij kinse
Kanë vërshuar milingonat
E verdha dhe të kaltra
Dhe si murtaja vërshuan qytetin

Ndoshta as që ka ekzistuar
Një përrallë e tillë
Por njerëzit janë të çuditshëm
Prej një tregimi për fëmijë
Krijojnë sagën
Të cilës as vetë s'besojnë

NJË BRETkosË E MOSHUAR

Kur na u boshatisëm xhepat
Asgjë çfarë na duhet
Nuk mbeti në pantallonat tona
I gjuajtëm edhe kujtimet e adoleshencës
Asgjë ama asgjë me vlerë
Nuk lëmë të shijojë pema

Te kopshti i vjetër roniten
Degët e thyera
Një bretkosë e moshuar
Dëneste te moçalishtja
Si bibat e majme
Tulaten në shtrojerë degët e plepave

Pasi që s'patëm se çfarë të bëjmë
U pajtuam me fatin
Njeriu me një trëndafil të kuq
Ishte afruar bustit të vetëm
Në qytetin e lumëbardhit
Dhe shijonte aromën e stinës

KOHËN KUR NË VEND TË NJERËZVE

Në këtë shkretim
Pranë kalldrëmeve të lashta
S'paskan ku të ulen pemët

Dikur ku uleshin zogjtë
I kanë prerë
Deri në rrënjë plepat

Asnjë stol s'shoh në bulevard
Nga ethet e stinës
Lëngon i tërë qyteti

Lëngojnë edhe algat e verdha
Kurse guralecët
Mbetën amanet i brigjeve

Ca gjethe dafine që rriten
Me lotin e bahçeve të Prizrenit
Ëndërrojnë me nostalgji

Ëndërrojnë të kaluarën
Kohën kur në vend të njerëzve
Aq bukur këndonin martinat

JU NUK ISHIT ASKUND

Nuk paska mbetur asnjë tregim
Në këtë qytet të ronitur
Këto mure të zgavërta
Sa shumë u shëmbëllejnë
Kuajve të drunjtë
Sa shumë u shëmbëllejnë thashethemeve

Nga ky ulli i djegur dhe i përdjegur
Po derdhen lumenj thëngjilli
Një lehje e egër nate
Paska mbetur pengë
Në lagjen e muhaxhirëve
Pengu i një kohe të vdekur

Ju nuk ishit askund
Kur nëpër qytetin e gurëve
Ushtarët e egër i shkullnin kalldrëmet
Lashtësia e çative
Shikonte me nostalgji
Barbarinë e një populli të huaj

ERA KËNDONTE ME NOSTALGJI

Po mbesim edhe pa këtë vjeshtë
Nën dritën e hënës lakuriqe
Qajnë xixëllonjat
Nëpër fytyrat e molisura të kalimtarëve
Derdhen lumenj rrudhash

Këto shtreza të tejdukshme
Paskan rënë sivjet
Shumë më herët seç duhet
Mollëzat çative të rrënuara
Pahiten në erë merimangat e verdha

Sa pak shi u shkundën nga retë
Sa kohë e trishtë
Ishte sivjet
Nga trungjet e ullinjve nxorëm
Avullin e ngrohtë të rrënjëve

Ishte kjo kohë e pakohë
Nëpër fusha s'i pamë gjinkallat
Në brigjet e një lumi të shterur
Pemët këndonin me nostalgji
Një këngë të vjetër baritore

DOLËN DHE IKËN FLUTURIMTHI

Në muzgun e parë
Heshtën zërat e kabanave
Një kukuvajkë me vjet nuk zbret
Nga kujtesa e saj
Orë e çast vajton degën e thyer

Edhe nëse të gjithë heshtin
Në lagje
Një zë vajtues
Si nga honi i kujtesës
Zbret nga strofujt e mjegullave

Zbret dhe në kor me bretkosat
Këndon një psalm të vjetër
Era ledhaton shqisat e të prekurit
Pema e vdekur
Te varret mbjellë të nesërmen

Sërish zgjohen kabanat
Nga çatitë e rrënuara dolën hapësirave
Zogjtë e fshehur të fëmijërisë
Dolën dhe ikën fluturimthi
Në disa hapësira të panjohura

MË KANË FOLUR MURANAT

Mëso ta ndjesh gjuhën e gurit
Këngën e suvalëve
Kur këndon anija e fundosur
Mëso të ndjehesh njeri
Dashnor i një malli të pashuar

Të bisedosh me gurin
Duhet të jesh shtatë herë
Më i fortë se shkëmbi i stralltë
Të këndosh kur qanë deti
Dhe të flesh kur zgjohen avujt

Forcën tënde të brendshme
Mos e kërko askund
Përpos në brendinë e pasqyrës
Nga e cila të ndjek kudo
Hija e jote e tejdukshme

E di që je më i fortë se shkëmbi
Më kanë folur muranat
Për fatin dhe forcën tënde
Mëso të jesh gur lum miku
I cili ndërton dhe nuk shemb kurrë

I MBYLLË DRITARET E NATËS

Sa herë që më zë pikëllimi
Dalë nga lëkura ime
Vrapoj si kali pa dizgjin
Vrapoj
Nëpër shtigjet e pa kaluara

Jashtë po bie shtreza e imtë
Nga ullukët e vjetër
Derdhen lumenj shirash
Këtu lagjen tonë
Asnjëherë s'këndojnë kukuvajkat

Kur dalim në bulevard
Shëtoret dhe stolat koten në gjumë
Vetëm ndonjë kalimtar i vonuar
I mbyll qepenat e natës
Për t'i hapur dyert e mbara të ditës

Dhe sërish si gjithmonë
Ky cikël i jetës vazhdon
Vazhdon me të njëjtin avaz
Duke i mbyllur qepenat
Dhe duke i hapur dritaret e ditës

I RUAN HISTORITË DHE NGJARJET

Postiqja dhe një grumbull fjalësh
Nëpër raftet e pluhurosur
Disa libra të vjetër
Mbi një tryezë
Qiriu i pashuar qëndron
Mbështetur për një shandan bronzi

Më shumë se njëqind vjet
Nga kjo odë e pritjes
Buburrecat e zeza s'morën arratinë
Këta qilima të papërdorur
Kush e di se në cilën kohë
I paska ngrënë mola e zezë

Oda rrethuar me raftet e gdhendur
S'flet asnjë fjalë
U ngjan përmendoreve të bronza
Në qetësinë e mureve
I ruan historitë dhe ngjarjet
E fshehura nën postiqen e moteve

MOS PREK NË KËTË MËNYRË KAQ TINËZARE

Ende kjo bishë po shkelë
Me të dy këmbët
Mbi plagët e hapura të njerëzve
Me një lloj qeshjeje ironike
Depërton në muret e zgavërta të shpirtit

Heshtë moj dridhje e pabesë
Shkule dhe tunde
Rrënjët e lisave
Dhe të varreve të hapur
Heshtë se do çmenden perënditë

Sërish me një zë prej bubullime
Galopon mbi lëkurën time
Galopon si kalorësit e çmendur apokaliptikë
Kurse dhembjet dhe plagët
E zgavërta sa vijnë e hapen

Mej moj bishë e tërbuar mej
Në daç hap plagë të reja në këtë gjoks
Por mos prek në këtë mënyrë kaq tinëzare
Lashtësinë shekujve
Në atdheun tim të tronditur

DUKESHIN ARKIVOLET E VULOSURA ME DYLLË

Mes katër mureve të plumbta
Frikën nuk e fsheha nga frika
As në ashtin tim
Mbi tërë atë peshë të rëndë
Sa drejtë i mbajta shpatullat

Nëpër lagështit e qelive
Dhe mureve të blinduar
Si askund në botë
Luhej një valle e trishtuar
Ajo e jetës me vdekjen

Loznin mendimet e zgavërta
Nga dritarja në miniaturë
Hynte një dritë e zbehtë
Sa që s'isha në gjendje t'i shoh
As gishtat kur i preja thonjtë

Kur binte muzgu i dytë
Nëpër korridore të errëta
Në heshtje mortore
Dukeshin arkivolet e vulosura me dyllë
Që vinin nga qelitë e fundme

SA JANË TË TRISHTUESHME BRITMAT

Sa janë të gjata këtu netët
Sa që as me tërkuzë samari
S'mund të maten trishtimet
E qelive të vulosura
Me gjak njeriu

Sa herë që vjen një i burgosur
Para se të vdes
Lë një amanet te muret
Që të dëgjohen vigmat
E trishtimeve të netëve

Sa janë të gjata këtu netët
E zgavërta
Sa janë të trishtueshme britmat
E qelive në errësirë
Sa që tmerrohen edhe vetë gardianët

ERA PËRTYP KOHËN E KALUAR

Në kopsht pemët kokëposhtë
Frynë e frynë stuhishëm
Acari i paparë
Nëpër lagje s'ndalen
Lehjet e pakontrolluara

Frikshëm lehin pemët
Shelgjishtet e pikëlluara të përroi
Rinë varur
Për rripin e pantallonave të grisura
Mjaullimat s'pushojnë te faltorja

Shumë pak fjalë kanë mbetur
Peng te muranat e rrënuara
Nën gjuhën e hënës
Era përtyp kohën e kaluar
Kurse të lehurat ende nuk mejnë

Kaluan njëmijë e njëqind vjet
U rrënuan kalatë
E kohërave më të lashta
Kurse ti ende ke mbetur
Kohë e humbur në kohën tënde të lehjeve

KURSE KUKULLAT PREJ PLASTIKE

Pas syzave të errësuar
Dy sy
Si dy gaca
Herë kyçen
E herë shkyçen si mendimet

Nëpër mëhalla s'pushojnë
Zërat e këndesave
Me kreshta të këputura
Përgjysmë
Dhe të atyre të metaltë

Një nënë e moshuar
I ka lidhur duart për koke
Dhe gjëma i dëgjohet
Në shtatë lagje
Nga lotët si shirat burojnë dhembjet

Syzat e errëta dhe maskat
E zeza fut
Marshojnë trotuareve
Kurse kukullat prej plastike
Me duar të prera i mbyllin sytë
Prishtinë, 4 dhjetor 2019

Cikli i tretë
Të ikësh nga atdheu

NËSE DUHET DO E FTOJMË EDHE KALANË

Më bëni zë kur të vini
Në qytetin tim
Do ju sjelli nga një zambak
Të bardhë
Te i cili linden dhe vdesin
Të gjitha pranverat e bukura

Ju premtova se nuk do t'ju lë
Pa zambak
Njëmijë dymijë vjet
Lumëbardhi i ka lyer buzët
Me dashurin e Jonit
Atje ku piqen ullinjtë e shëndetshëm

Sonte kam një festë të madhe
Vendosa të ngrehi dolli
Me guralecët
E të gjitha ngjyrave
Nëse duhet do e ftojme edhe kalanë
Të pimë e të dehemi me dashurinë e saj

DERI KËTU KU PËRMENDORET

Ju nuk ishit të pranishëm
Kur ndjeva thellë në zemër
Thirrjen e së kaluarës
Erdhën vrap
Kalorësit e të gjitha kohërave
Erdhën edhe etërit e mi krenarë

Nuk pata shumë kohë
Për njëqind vjet
Mbase edhe më shumë
Merresha me punët e ftesave
Një stinë më mungonte letra
Kurse stinën tjetër bishtpena

Por gjithsesi unë kurrë nuk u ndala
Aq shumë i besova vetvetes
Sa që pata fat
Të mbërrit tok me djemurinë
Deri këtu ku përmendoret
I bëjnë roje nderi atdheut

TË JESH NJË NJERI I PAVARUR

Mbetëm në mes të udhës
Kah të ja mbajmë
Këtu Ferri
Pas shpine bijtë e luciferit
Kurse lehja e cerberëve
S'kishte të ndalur në kokën time

Polici na fliste me një gjuhë
Të çoroditur për ne
I shtrembëronte nofullat e sipërme
Ecja dhe veshja e tyre
Kishte një tjetër peshë të rëndë
Në sytë tanë të lëbyrta

Kur kuptuam se s' jemi të huaj
Në vatrat tona
Ndoshta edhe prej fqinjëve mësuam
Se sa është mirë
Të jesh një njeri i pavarur
Lakmuam ta shijojmë bukurinë e lirisë

TË IKËSH NGA ATDHEU

Të ikësh nga atdheu
Domethënë të vdesësh për së gjalli
Një urrejtje e sëmurë
Lind urrejtjen tjetër më patologjike
Të ikësh nga atdheu
Domethënë të jesh një kufomë e gjallë

Të nisesh për diku duke ia kthyer shpinën
Pemëve në kopsht
Dhe dritareve të errësuar
Ta lësh pas shpine lotin e ngrohtë
Të adoleshencës
Je i çmendur ose që nesër do çmendesh

Të ikësh nga atdheu t'i lësh peng
Kujtimet e gurëve të murrmë
Oxhakun e rrënuar të shtëpisë
Ku gjithmonë do të të vajtoj
Një këndes i metaltë
S'do jesh asgjë tjetër përpos një kufomë

VETËM FJALË PREJ BRYME

Mbi tryezën e punës së përditshme
Flenë librat e vjetër
Biblën e ka zënë në befasi
Një gjumë i përdalë
Dhe kohë pas kohe kotet në prehrin
E viteve të shkuara

Në krahun e djathtë e kemi vendosur
Një tjetër libër
Nga koha e faraonëve
Kurse Meshari kokëfortë si gjithmonë
Në duel me vetveten
I shfleton faqet e Kanunit

Edhe Lekën po e mundon një letargji
Ikën kohërat e mira
Do thoshte Hanko Halla
Vetëm fjalë prej bryme
Pikojnë nga çatitë e ronitura
Pikojnë si rrëshira strofujt e merimangave

PLEPI I ZGAVËRT

Pyes vjetërsinë e çative
Këndesin e metaltë
Sa e rëndë qenka heshtja
Kur njeriu s'merr asnjë përgjigje
Kurse shiu i bezdisshëm
Troket në kreshtën e ndryshkur të këndesit

Një fjalë dikur moti
Më ka mbetur peng në kujtesë
Atë ditë të shurdhtë
Më së miri e kuptova unë
Lotin e hidhur të plepave
Kuptova dënesën e këndesit mbi çati

Shumë mote të mira dhe të liga
Ndryshuan që nga ajo ditë
Plepi i zgavërt
Stoikisht qëndronte në të njëjtin vend
Vetëm zgërbonja dallohej
Nga plagët e viteve të shkuara

QIPARISAT E NJË TJETËR ËNDRRE

Kur mbetem fillikat
Si i çmendur
Vrapoj nëpër ëndrrat e mia
Vrapoj aq shumë
Sa që më zihet frymëmarrja

Shikoj përtej pasqyrës
Në thellësinë e saj
I shoh gratë më të bukura
Kurse unë vrapoj
Për ta kapur ëndrrën time

Tërë jetën ngarenda
Pas një ëndrre
Dhe sërish mbeta pa ëndrra
Një lis i vetmuar në shtrojerë
Frymon si rrënjët e stinëve

Kur ndalem nëse kam kohë
Për vetveten time
Shikoj përreth meje plepat e prerë
Qiparisat e një tjetër ëndrre
Të pa ëndërruar asnjëherë

NGA SYTË E PËRGJUMUR

Pa zbritur sterra e parë
Si në gjerdek
Lëshohen ngadalë qepenat
Po ashtu edhe dritaret
E rënda të qytetit
I lëshojnë perdet shumëngjyrëshe

Pas pak çasteve qyteti i mistereve
I shëmbëllen teatrit antik
Kyçen dritat e kuqe
Sa që i tërë bulevardi i dëshmorëve
I ngjan një fluturë
Të madhe dhe gjigante

Mbushen kafenetë e zbrazëta
Aty këtu tek tuk
Dëgjohet ndonjë muzikë e shturur
Zërat e natës sa vijnë e shtohen
Sytë e pagjumë
S'mund t'i mbyllin qepenat

Kurse mëngjesi i kotur
Mbi një plep të kalbur
I fërkon sa shumë i fërkon zgërlaqet
Nga sytë e përgjumur
Edhe kjo ditë e kjo e natë pa ëndrra
Do notoj si e dehur
Mbi tavolinën e dhembjes

ASKUND NUK SHOH NJERI

Vrapoj hapësirave
Ëndrra ime e bardhë rri
Mbi qepallat e thyera
Kjo ditë e gjatë
Paska mbetur në fillim të udhës

Shikoj lartësitë e paepura
Një grusht re
Në xhepat e grisur të mjegullave
Me kokëfortësi fundoset
Deri te e nesërmja

Pasqyra e thyer rri varur në degë
Në brendinë e saj
I kam fshehur të gjitha ëndrrat
Kjo kohë pa të nesërme
Kush e di se ku i humbi imazhet

Sërish vrapoj lëndinave
Vrapoj si kaprolli i plagosur
Nëpër një shteg të imagjinuar
Askund nuk shoh njeri
Qyteti paska mbetur amanet kukuvajkave

PËR ÇUDI KËTU NJERËZIT

Qiriu në të sosur pikëllueshëm
I ka hapur sytë
Në drejtim të shandanit
Një flutur e plagosur në krahun e djathtë
Mbart mbi vete pikëllimin e ditës

Asnjë ndryshim në brendinë
E pasqyrës së thyer
Zëri heshtur i kambanës
I ngjan një shurdhmemeci
Të cilit i ka humbur busulla

Jashtë në oborr thëllimi i verdhë
Rri kacule si gjithmonë
Pranë ullukëve të ndryshkur
Qe njëqind vjet
Nuk pat shi në lagjen tonë

Pyetëm banorët rezident
Për këto ndryshime atmosferike
Askush asnjë fjalë nuk tha
Për çudi këtu njerëzit
Sa janë të huaj për njëri-tjetrin

ORENDITË TOK ME PANTALLONAT E MIA

Në sirtarin e pluhurosur
Ka kohë
Që në vend të librave
Vendosa hinoren
Dhe flokët e erës prej hiri

Një zjarr i madh
Ai i verdh me ngjyrë të flaktë
Që i shëmbëllente atij të Olimpjit
Natë e ditë ndizet
Në përrallën e një legjende

Ne u plakëm
U plakëm moj grua
Fëmijët e morën dynjanë në sy
Ku sot nesër dhe gjithmonë
Aroma e tyre na mban gjallë

Në shtëpinë tonë janë plakur
Fotografitë e dikurshme
Orenditë tok me pantallonat e mia
Por për çudi
Kujtimet nuk dinë të plaken

Prishtinë, 5 dhjetor 2019

RA NË DY GJUNJË NJERËZIMI

Ra mbretëria e Trojës
Ra për të lind një tjetër yll
Në tokën e lëruar të arbrit

Po bien në kokërr të shpinës
Edhe mbretëritë e tjera
Si kulla prej letrave
Të mykura
Po bien mbretërit dhe shtetet

Ra Kruja në themelet e saja
Po bien kokëposhtë
Edhe perënditë
Tok me Zeusin

Vetëm një yll po ngritët
Në kështjellat e atdheut
Asgjë nuk mbeti në këmbë
Pas vdekjes së zotave
Filluan të këputen edhe meteorët

Hundë e buzë
Po bien të mëdhenjtë
Dhe të vegjlit
Kalatë e dynjasë
Po u dorëzohen rrënojave

Ra në dy gjunjë njerëzimi
Ra dhe po bien
Një nga një
Edhe perënditë e shenjtë të Olimp

NËN KËMBË I DRIDHEJ TOKA

Atë çast ishte koha e vranët
Nëpër çatitë e lagjeve sorollatej
Mjegulla e dendur

Me vite pritëm shiun e vonuar
Dhe me sy kah qielli
Shikonim
Diellin se si lozte me retë

Nuk pritëm shumë kohë
Në hapësirën e ngrysur
Pamë një të çarë të zezë

Pamë
Se si depërtonin retë e plumbta
Mbi çatitë e etura të pritjeve

E shiu kaherë i pritur
Kurrsesi të mbërrinte në tokën
E premtuar të etërve

I valonte koka
Nën këmbë i dridhej toka
Ishte i bezdisur nga torturat e pritjeve
Prite me padurim shiun e lirisë

KALI IM I ZI

Si pa kokë vrapoj
Nëpër vorbullën e turbullt
Të kujtimeve
Nën tokë byrytet qielli
Kurse mbi kokë
Deri në Ferr largohej dielli

I mbështetem rrapit plak
Ashtu siç më mbështetet rrap
Më duket se jemi
Një duet i përkryer
Për këtë tango të vonuar
Më shumë se njëqind vjet

Si pa kokë kali im i zi
Galopon përtej hapësirave
Kudo zbrazëti
Nën potkonjtë e shpresës
Kali im i zi
Hingëllon në gjuhën e qiellit

UNË SËRISH DO DALË NGA AI FERR

Mendoni se mund të më thyeni
Ju kujtohet
Kur m'i mbyllët
Të gjitha dyert e hekurta
S'latë asnjë dritare të hapur
Mes katër mureve të urrejtjes
Mbollët pemën e trishtuar

Ju thashë se nuk mund të më thyeni
Jam gur i pjekur
Nën shtatë pllakat e diellit
Sa herë që deshët të më dërmoni
Me kanxhat e juaja të hekurt
Unë shtatë herë më i fortë dola
Nga një betejë e pabarabartë

Para njëqind vjetëve ju pata thënë
Se jam i pathyeshëm
Edhe nëse ma shembni
Përfundimisht qiellin e zi
Mbi kokë
Unë sërish do dalë nga ai ferr
Dhe do qëndroj si titan mbi tokë

Nuk më thyen dot rrebeshet as stuhitë
Nga zjarri u linda
Dhe sërish jam zjarr
Kurrë s'i shëmbëlleva hirit
Feniksin e pata vëlla prej gjaku
Fluturova hapësirave të paanë
Po desha edhe sot fluturoj matanë
Prishtinë, 6 dhjetor 2019

Adem Zaplluzha u lind më 1943 në Prizren, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Një kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime, kryesisht me poezi ,filloi të merret që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë të cilën e botoi në revistën “Pionieri”, më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës bashkë me shokët e punës dhe pendës themeloi grupin letrar “Lulëkuqet e Kosovës”. Në kuadër të punës së këtij grupi letrar qe botuar përmbledhja “Ngjyra e kohës”, në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa Antologji dhe në librin “Kosova letrare” të poeteshës Monica Mureshan.

Është prezantuar në Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990, nga Hasan Hasani, në Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 - 1995 nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin Portrete Shkrimtarësh nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002.

Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i Shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe. Jeton dhe krijon në Prishtinë.

BOTIME TË AUTORIT

1. “Puthje”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë, 1974.
2. “Ecjet e viteve të mëdha”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. “Çamarrokët e Thepores”, poezi për fëmijë, “Shkëndija”, Prishtinë 1996.
4. “Muret”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997
5. “Morfologjia e dhembjes”, poezi, “Faik Konica”, Prishtinë, 2000
6. “Ai vjen nesër”, poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2007
7. “Letër nga mërgimi”, poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu” Kastriot, 2007
8. “Letër nga mërgimi 2 “ poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. “Udhëdarja”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
10. “Thirrje e gjakut”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. “Asgjë sikur molla”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. “Vesa në lotin tim”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “Puthja e gozhduar”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2009.

14. “Kashelasha në vargje”, poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2009.
15. “Pema e bekuar”, E përkthyer, Rumani, 2010.
16. “Bajraktarët e vatanit”, poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. “Hijet e ndryshkura”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
- 18.”Stuhi në Kutulishte”, poezi, ”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
19. “Posa ikte nata”, poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot, 2010.
20. “Loja e myshqeve”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
21. ”Lumëbardhi dhe gjëma”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010
22. “Metafora e heshtjes”, poezi, “Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010
23. ”Hyji në Prekaz”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot, 2010.
24. ”Sinorët e hinores”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot 2010.
25. ”Don Kishoti dhe Rosinanti”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
- 26.”Zjarri i dashurisë”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
27. ”Kur likenet vallëzojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
28. “Ditari në vargje”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
29. “Tingujt që nuk përfundojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010.

30. “Shtegu i mallit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
31. ”Korniza e thyer”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
32. “Zgjimi i gjëmës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtareve, Kastriot, 2010
33. “Vallja mistike”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010

34. ”Merre kodin”, Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
35. “Letër atdheut” poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
36. “Tejdukshmëria e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
37. “ Përtej teje”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
38. “Sa afër e sa larg”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
39. “Vallja e zanoreve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
40. “Ikja e eshtrave”, Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011

41. ”Kalorësit e mjegullave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
42. “Hingëllimat e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
43. “Kur pemët i ndërrojnë këmishët”. Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
44. “Mirëmëngjesi Imzot”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012

45. “Kafshimi i mikut”, Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
46. “Atje tej maleve”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot, 2012
47. “Heshtja që del në shesh,” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
48. “Portat e shpresës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
49. “Në dhomën time gjysmë të errët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
50. “Kinse Lojë Shahu”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
51. “ Për çdo dekadë nga një baladë “, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
52. “Fusha e mëllenjave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
53. “E kujt është kjo vetmi”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
54. “Mos pyet për adresën e lumit”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
55. “ Stoli në parkun vjetër” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
56. “Urori i stralltë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
57. “Po të mos ishte fjala”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot,2012
58. “Thyerja e urave”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
59. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
60. “ Në flokët e dëborës”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012

61. “Një grusht nostalgji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
62. “ Kur filluan të flasin njerëzit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
63. “Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
64. “ Lisi në rrënjët e veta” , Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012
65. “Eca ecëm dhe do ecim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
66. “Fëmijët e erës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012
67. “ Çast në fund të stinës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
68. “Si të flas me drurët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
69. “ Më pëlqejnë mendimet e tua”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
70. ”Andej dhe këndej kohës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
71. “Zëri i heshtjes”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
72. “Kush i lexoi letrat prej erës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
73. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”, prozë poetike, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
74. “Koha e ime dhe koha e jote”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
- 75.” Diku te një baladë”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
76. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012

77 “ Ky def prej hëne”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

78.“Pyesni zogjtë në ikje ”,Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot 2013

79 “ Fërfërimë gjethesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013

80. “Refrene yjesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013

81. “Te delta e mjellmave”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013

82.“Rinjohja”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013

83.“Diku në fund të një fillimi”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013

84.“Mëkati i hijes”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013

85.“Një zog prej uji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013

86.”Asnjë fjalë nuk frymon”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.

87.”Daullet e një nate”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014

88.”Sytë e gurtë të erës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014

89.”Kur dehen perënditë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014

90. “Fjetëm njëqind shekuj” Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.

91.”Kraçëllimat e natës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014

92. “Ndjekësit e enigmave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
93. “Atdheu i paçmuar”Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
- 94.”Psalm i harruar ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”Kastriot 2014
- 95,”Për kë po bie moj kambanë”, Poezi Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
96. “Mbi flokët e ullukëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
97. “Menatë vijnë lejlekë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
98. “Loti i gotës së dehur” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
99. “Stina asnjënëse”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
100. “Dëneste bashkë me erën” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
101. “Druri i pikëlluar”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
102. “Një grusht dashuri”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
103. “Lëreni zërin tim”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
104. “Shi në qytetin tim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
105. “Si trenat e verbër ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
106. “Zjarri i malli tim ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
107. “Kur teshtin era”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014

108. “Mbi shpirtin e erës pagane”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
109. “Nëpër gjymtyrët e mjegullave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
110. “Ajo nuk erdhi sonte” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
111. “Një hënë e zhveshur”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
112. “Nëpër plasaritjet e mureve”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
113. “Mes telave gjembor ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
114. “Të vizatosh një zog në mur”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
115. “Nuk flenë as kuajt e dehur” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
116. “Fluturojnë zogjtë e verbër ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
117. “Një shi prej bryme” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
118. “Në prehrin e pemëve” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
119. “Zëri i largët i shiut ”, Poezi Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
120. “Yjet e ngrira të kujtesës ” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
121. “ Thirrmat e hijeve”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
122. “Dritaret e verbëta ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015

- 123 . “Përtej portave të mbyllura” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
124. “Malli i etjes” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
125. “Kur qajnë pemët ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
126. “Të dielave në qytetin tim ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
127. “ Njëpër brigjet e kujtesës” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
128. “Rrugës qante një stërçok”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
129. “Kali im prej bore” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
130. “Përballë hijes së mollës ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
131. “Jehu i zërave”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
132. “Në kujtesën e pemëve ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
- 133.“Më mirë një gjysmë ëndrre ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
- 134.“Një dry prej dylli ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016.
- 135.“ Në anën tjetër të mendjes”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
- 136.“Sa shumë ethe pat dimri sivjet”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
137. “Enigmat e kashelashave ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
138. “Nuk i them unë dot kësaj liri” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016

139. “Fluturat prej letre ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
140. “Fluturimi i gjinkallës”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
141. “Kumritë prej deltine”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2016
142. “Më pritni te baladat e gurit”, poezi, Shtëpia Botuese “TRENDI”, Prishtinë, 2017.
143. “Trenat këtu gjithmonë vonohen”, Poezi, Shtëpia Botuese “TRENDI”, Prishtinë. 2017
144. “Lulëzojnë gjethet e ullinjve”, poezi, Shtëpia Botuese “TRENDI”, Prishtinë, 2017
145. “Teatri antik i kujtesës”, Poezi, Shtëpia Botuese “TRENDI”, Prishtinë. 2017
146. “Portreti i lirisë”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2017
147. “Një stinë delikate”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2017
148. “Te ullishtat e vjetra ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TRENDI”, Prishtinë. 2017
149. “Ishim të lumtur si gjinkallat”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2017
150. “Pikëllimet e rrënjëve”, Poezi, Shtëpia Botuese “TRENDI”, Prishtinë. 2017
151. “Telat e shirave ” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2017
152. “Një stuhi prej bryme”, Poezi, Shtëpia Botuese “TRENDI”, Prishtinë. 2018
153. “Sonte s’ka dashuri ” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
154. “i shëmbëllente pluhurit kozmik”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2018

- 155.“Llamburite atdheu i plagosur” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 156.“Gurët e pjekur shtatë herë” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
157. “Kur të dalë nga kjo stinë” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 158.“Ishin thyer te gjitha urat ” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 159.“Gjethi i këputur në vjeshtë ” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 160.“Ti mundesh nëse do” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 161.“Pëllumbat prej rrufeve”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
162. “Diku në zbrazëtinë e ndërgjegjes”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 163.“Retë e dendura të kujtesës ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 164.“ Pak diell e shumë acar”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
- 165.“Kur kyçen yjet e harresës ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
- 166.“Nga pragjet e shtëpive”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
- 167.“Fluturat e djegura ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
- 168.“Përtej asaj peme”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
- 169.“ Kuajt e mjegullave”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
- 170.“Po të ishte ndryshe ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019

171. “Kur kthehen zogjtë e shiut ”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2019
172. “Mes gishtave të hijes”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2019
173. “kush i theu xhamat e shiut”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2019
174. “Poemat e dhembjekrenarisë ”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2019
175. “Marsi i çmendur në dy kohës”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2019
176. “ Kur dënesin varret”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2019
177. “ Mos më uroni udhë të mbarë”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë
178. “Nuk mjafton të kesh vetëm emër ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2020
179. “Portat e mbyllura me dyllë ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2020
180. “Deri në baladën tjetër ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2020
181. “ Bleta e kaltër”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2020
182. “_Nën vezullime yjesh ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2020
183. “Duart e zhagmitura_ ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2020
184. “psherëtimat e gurëve ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2020
185. “Atdheu im i dhembjeve_ ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2020

186.“Vazoja me një pallto gri ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë,2020

187.“ Një hingëllimë si një gjëmë ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë,2020

188.“ Çfarë bëra për ty atdhe”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë,2020

189.“ Te një stinë e harruar”, poezi, Shtëpia Botuese Prishtinë,2020

190.“Më kanë folur muranat ”, poezi,Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë,2020

PËRMBAJTJA

Cikli i parë

Mos u dorëzo nga ky tërmet.....17

| | |
|--------------------------------------------|----|
| Loton çdo ashkël dërrase..... | 19 |
| Nga dhembja po shkulen çatitë..... | 20 |
| Hapen zemrat e mbyllura me gur..... | 21 |
| Diku dënes edhe një nënë..... | 22 |
| Errësira e verbët tërë habi..... | 23 |
| Stërkalat e mëngjesit vdesin nga uria..... | 24 |
| Kjo stinë e vdekjeve..... | 25 |
| U gjunjëzuan pemët..... | 26 |
| Dënes si një kërthi i braktisur..... | 27 |
| Askush nuk bëzan..... | 28 |
| Kjo natë e gjatë e tmerrit..... | 29 |
| I numërova edhe ata..... | 30 |
| Mbi varkat e fundosura..... | 31 |
| Mos u dorëzo nga ky tërmet..... | 32 |
| Lëvizën gurtë e murrmë të atdheut..... | 33 |
| Është dridhja e shpirtit të atdheut..... | 34 |
| Kjo gjëmë mbi gjëmën e tokës..... | 35 |
| Mustaqe prerë një plak..... | 36 |
| Ne do jemi gjithmonë këtu..... | 37 |
| Sa i trishtuar do jetë dimri sivjet..... | 38 |
| Po kthehen..... | 39 |
| Dhe u plandos..... | 40 |
| Mbi flokët e thinjura të vjeshtës..... | 41 |
| Një pulëbardhë posa e ardhur..... | 42 |
| Do ua zgjatë dorën e shpëtimit..... | 43 |
| Këto pemë paskan mbetur pa lot..... | 44 |

Cikli i dytë

Më kanë folur muranat.....45

| | |
|-----------------------------------------------|----|
| Kurse zjarret dogjën dhe i poqën..... | 47 |
| Nga një faltore e huaj..... | 48 |
| Megjithatë më kanë thënë..... | 49 |
| Unë sërish..... | 50 |
| Ishim fëmijët e yjeve..... | 51 |
| Thëllimi në kopsht..... | 52 |
| Nën degët e një gështenje..... | 53 |
| I numëron ditët e fundit..... | 54 |
| Kush i hapin këto varre..... | 55 |
| Në brendinë e pasqyrave..... | 56 |
| Pritnim ardhjen e pranverës..... | 57 |
| Me krahët e saja të këputura..... | 58 |
| S'men në asnjë kohë..... | 59 |
| Ku banonte dikur poeti..... | 60 |
| Krijojnë sagën..... | 61 |
| Një bretkosë e moshuar..... | 62 |
| Kohën kur në vend të njerëzve..... | 63 |
| Ju nuk ishit askund..... | 64 |
| Era këndonte me nostalgji..... | 65 |
| Dolën dhe ikën fluturimthi..... | 66 |
| Më kanë folur muranat..... | 67 |
| I mbylli dritaret e natës..... | 68 |
| I ruan historitë dhe ngjarjet..... | 69 |
| Por mos prek në këtë mënyrë kaq tinëzare..... | 70 |
| Dukeshin arkivolet e vulosura me dyllë..... | 71 |
| Sa janë të trishtueshme britmat..... | 72 |
| Era përtyp kohën e kaluar..... | 73 |
| Kurse kukullat prej plastike..... | 74 |

Cikli i tretë

Të ikësh nga atdheu.....75

| | |
|-----------------------------------------|----|
| Nëse duhet do e ftojmë edhe kalanë..... | 77 |
| Deri këtu ku përmendoret..... | 78 |
| Të jesh një njeri i pavarur..... | 79 |
| Të ikësh nga atdheu..... | 80 |
| Vetëm fjalë prej bryme..... | 81 |
| Plepi i zgavërt..... | 82 |
| Qiparisat e një tjetër ëndrre..... | 83 |
| Nga sytë e përgjumur..... | 84 |
| Askund nuk shoh njeri..... | 86 |
| Për çudi këtu njerëzit..... | 87 |
| Orenditë tok me pantallonat e mia..... | 88 |
| Ra në dy gjunjë njerëzimi..... | 89 |
| Nën këmbë i dridhej toka..... | 91 |
| Kali im i zi..... | 92 |
| Unë sërish do dalë nga ai Ferr..... | 93 |

